



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:261197
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06019263

Kom.Dh.Shk.II.nr.841/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtar Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit Eksklusiv, Sh.P.K., me seli në Gjilan, rr. “Abdullah Tahiri”, me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve SCLR Partners, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, në çështjen përmbartimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2018/23 dt. 28.12.2023, më datën 05.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2018/23 dt. 28.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.2018/23 dt. 28.12.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë dhe anulohet pjesërisht kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 i lejuar nga Përmbartues Privat Besnik Aliu, për pjesën e kamatës prej 8% nga data 27.09.2021 e deri në përmbushjen definitive. Në pikën II të dispozitivit refuzohet pjesërisht si i pa bazuar prapësimi i debitorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë dhe mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 i lejuar nga Përmbartues Privat Besnik Aliu, me të cilin është caktuar përmbartimi për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 37,373.95 euro. Në pikën III të dispozitivit përfundon pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Eksklusiv, Sh.P.K., me seli në Gjilan, sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 i lejuar nga Përmbartues Privat Besnik Aliu, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% nga data 27.09.2021 e deri në përmbushjen definitive. Në pikën IV të dispozitivit detyrohet debitorit që në emër të

shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t'ia paguaj kreditorit shumën prej 312.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor debitori, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa, dhe aktvendimi i atakuar të prishet dhe lënda ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, apo aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe urdhrin përmbartimorë i përmbartuesit privat P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 ta shfuqizoje dhe të llogaritet kamatë vonesa siç parasheh neni 382 pika 1 dhe 2 të ligjit Nr.04/L-077 të LMD-së.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimorë si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhër Përmbartimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023, në bazë të dokumentit përmbartues – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr. 1526/19 të datës 16.06.2021, me të cilën është detyruar debitori, që kreditorit në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 37,373.95 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data 27.09.2021 si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimorë.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor me arsyetimin se kreditori nuk ka kërkuar kamatën në dispozitiv të dokumentit përmbartimor dhe për këtë arsye urdhëri nuk është lëshuar sipas procedurës përmbartimorë. Gjithashtu kreditori ka pretenduar se debitori nuk ka paguar shumën prej 37,373.95 €, mirëpo debitori nuk e ka paguar për faktin se kreditori nuk e ka ofruar dokumentacionin e nevojshëm që të paguaj shumën. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim, me arsyetim se debitori ka ngatërruar institutet e marrëdhënies së detyrimit lidhur me kamatën dhe kamatëvonesën e në rastin konkret kreditori ka kërkuar kamatëvonesën pas rënies në vonës të debitorit në përmbushjen e detyrimit në të holla në afatin partitiv të dhënë nga gjykata..

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.2018/23 dt. 28.12.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë dhe anulohet pjesërisht kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 i lejuar nga Përmbartues Privat Besnik Aliu, për pjesën e kamatës prej 8% nga data 27.09.2021 e deri në përmbushjen definitive. Në pikën II të dispozitivit refuzohet pjesërisht si i pa bazuar prapësimi i debitorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë dhe mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 i lejuar nga Përmbartues Privat Besnik Aliu, me të cilin është caktuar përmbartimi për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 37,373.95 euro. Në pikën III të dispozitivit përfundon pjesërisht procedura përmbartimorë e kreditorit Eksklusiv, Sh.P.K., me seli në Gjiilan, sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 i lejuar

nga Përmbarues Privat Besnik Aliu, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% nga data 27.09.2021 e deri në përmbushjen definitive. Në pikën IV të dispozitivit detyrohet debitorit që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t'ia paguaj kreditorit shumën prej 312.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas analizimit të propozimit për përmbarim, shqyrtimin si dhe vlerësimi të provave në shkresat e lëndës, mbi bazën e dokumentit përmbarues – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr. 1526/19 të datës 16.06.2021, i formës së prerë me datë 27.09.2021 dhe i ekzekutueshëm prej datës 30.10.2023, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të gjobës dhe shpenzimeve të procedurës përmbarimore, t'ia paguaj shumën prej 37,373.95 €. Prandaj, mbi këtë bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet e parapara me nenin 21, 22, 23, 24 dhe 27 par.1 të LPP-së. Gjithashtu plotësohen kushtet edhe sipas nenit 38 par. 1 të LPP-së përcaktohet se: ” Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”. Gjykata shfuqizoi pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023 të Përmbaruesit Privat Besnik Aliu, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përmbarimor, pasi që urdhri përmbarimor nuk është në përputhje me dokumentin përmbarimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim, për faktin se debitori sipas dokumentit përmbarimor është obliguar që në emër të mallit të konfiskuar i cili i ishte Zhdoganuar t'ia kompenzoj shumën e përgjithshme prej 37,373.95 €, mirëpo jo edhe pjesën e kamatës ligjore, andaj gjykata ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar. Sa i përket shpenzimeve gjykata është bazuar në nenet 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me 17 dhe 13 të LPP-së, duke ja njohur shpenzimet e kreditorit në shumë prej 312.00 euro, sipas tarifave e avokatëve të datës 18.03.20217.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbarimore.

Kjo gjykate vlerëson se ne rastin konkret Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr. 1526/19 të datës 16.06.2021, i formës së prerë me datë 27.09.2021 dhe i ekzekutueshëm prej datës 30.10.2023, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të gjobës dhe shpenzimeve të procedurës

përmbartim, t'ia paguaj shumën prej 37,373.95 €, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qene dokument përmbartimor me titull ekzekutiv, sepse i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 21, 22, 23, 24 dhe 27 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbartimi, Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr. 1526/19 të datës 16.06.2021, përben bazën juridike për caktimin e përmbartimit, pasi që paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, në të cilin përcaktohet se “ *Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, nenit 22 par.1 pika 1.1 të LPP-së, me të cilin përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë “ *Vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese*”, neni 23 para.1 përcaktohet se: “ *vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit*”, dhe me nenin 24 par. 1 përcaktohet se: “ *Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbartja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbartueshëm po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbartje vullnetare*“. Në rastin konkret, Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr. 1526/19 të datës 16.06.2021, i formës së prerë me datë 27.09.2021 dhe i ekzekutueshëm prej datës 30.10.2023, i përmban elementet e një vendimi të organit administrativ, dhe se e ka cilësinë e dokumentit përmbartues edhe sipas nenit 27, LPP-së, ku përcakton se “ *Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit*”. Po ashtu dokumentit/ Aktgjykimi, nuk i mungon forma e saktë ku së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri, sipas nenit 36 par.1 të LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lendes rezulton se vendimi mbi të cilin përmbartuesi privat e ka lejuar urdhrin përmbartimor të debitorit me Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamentit për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr. 1526/19 të datës 16.06.2021, i formës së prerë me datë 27.09.2021 dhe i ekzekutueshëm prej datës 30.10.2023, paraqet dokument përmbartimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se përmban vullën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbartimor i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimor.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës

Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbaremore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi pjesërisht urdhrin për caktimin e përmbaremit të Përmbareuesit Privat, P.nr.545/2023 të datës 31.10.2023.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.841/24 dt.05.082024

Gjyqtar,
Faton Bajrami.